



VENDIM

Nr. 41, Datë 12.04.2016

MBI

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC LASHKIZA” SH.P.K. NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC-ET “LASHKIZA 1” ME FUQI TË INSTALUAR 4076 KW DHE
“LASHKIZA 2” ME FUQI TË INSTALUAR 882 KW (ME FUQI TOTALE
TË INSTALUAR 4958 KW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Lashkiza” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec-et “Lashkiza 1” dhe “Lashkiza 2”,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “Hec Lashkiza” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “Hec Lashkiza” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Lashkiza 1” me fuqi të instaluar 4076 KW dhe “Lashkiza 2” me fuqi të instaluar 882 KW (me fuqi totale të instaluar 4958 KW), për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 41, Datë 12.04.2016

MBI

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC LASHKIZA” SH.P.K. NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC-ET “LASHKIZA 1” ME FUQI TË INSTALUAR 4076 KW DHE
“LASHKIZA 2” ME FUQI TË INSTALUAR 882 KW (ME FUQI TOTALE
TË INSTALUAR 4958 KW)**

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|----------------------|-------|--------|
| Petrit Ahmeti | _____ | _____ |
| Adriatik Bego | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Maksim Shuli | _____ | _____ |